



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 238, Datë 27.07.2023

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1832/6 prot., datë 26.07.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1832 prot., datë 22.06.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 217, datë 04.07.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 05.07.2023 dhe 06.07.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 14.07.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1832/3 prot., datë 10.07.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e plotësuar pjesërisht të këtij aplikimi.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1832/4 prot, datë 11.07.2023 dhe nr. 1832/5 prot., datë 18.07.2023, shoqëria depozitoi dokumentacion plotësues të këtij aplikimi.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërisë “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrje,s të njoftojë shoqërinë “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI